

VENDIM
Nr. 468, datë 9.7.2014

PËR PËRBËRJEN, KOMPETENCAT DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT SHTETËROR TË MUZEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr. 9386, datë 4.5.2005, “Për muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PËRBËRJA

1. Komisioni Shtetëror i Muzeve (KSHM) kryesohet nga ministri i Kulturës dhe ka në përbërje 10 anëtarë, përfaqësues të institucioneve të specializuara dhe personalitete të fushës së trashëgimisë kulturore, si më poshtë vijon:

- Drejtorin e Përgjithshëm të Planifikimit Strategjik për Trashëgiminë dhe Diversitetin Kulturor;
- Drejtorin e Drejtorisë së Trashëgimisë Materiale dhe të Muzeve;
- Drejtorin e Muzeut Historik Kombëtar;
- Drejtorin e Institutit të Monumenteve të Kulturës;
- Drejtorin e Galerisë Kombëtare të Arteve;
- Përfaqësuesin e Institutit të Historisë (QSA);
- Përfaqësuesin e Institutit të Arkeologjisë (QSA);
- Përfaqësuesin e Institutit të Antropologjisë Kulturore (QSA);
- Përfaqësuesin e Akademisë së Shkencave;
- Përfaqësuesin e Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Histori – Filologjisë.

2. Përfaqësuesi i ICOM - Shqipëri dhe përfaqësuesi i ICCROM - Shqipëri janë anëtarë të Komisionit, pa të drejtë vote.

3. Një jurist i Ministrisë së Kulturës asiston në të gjitha mbledhjet e Komisionit Shtetëror të Muzeve, pa të drejtë vote.

4. Specialistët e sektorit të arkeologjisë, trashëgimisë së luajtshme dhe muzeve, në Ministrinë e Kulturës, përbëjnë sekretarinë teknike për KSHM-në.

II. KOMPETENCAT

Komisioni Shtetëror i Muzeve ka këto kompetenca:

1. Harton dhe miraton kriteret që duhet të plotësohen për hapjen e muzeve dhe zhvillimin e veprimtarisë nga muzetë privatë.

2. Harton dhe miraton formularin zyrtar për zyrtarizimin e muzeve publikë dhe privatë.

3. Harton dhe miraton normat dhe specifikimet tekniko-profesionale e metodologjike për:

- a) funksionimin dhe administrimin e muzeve, si dhe të shërbimeve që ofrohen prej tyre;
- b) ruajtjen, mirëmbajtjen dhe sigurinë fizike të muzeve e të fondit muzeor dhe rregullat kombëtare në fuqi mbi fondin arkivor.

Këto norma janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë muzetë në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga përcaktimi, varësia apo tipologjia.

4. Përgatit, administron dhe publikon regjistrin e muzeve publikë dhe privatë.

5. Shqyrton propozimet për hapjen e muzeve të rinj dhe, pasi verifikon plotësimin e procedurave të sipërpërmendura, rekomandon ose jo lëshimin e “lejes zyrtare” për hapjen e muzeut të ri.

III. FUNKSIONIMI

1. Komisioni Shtetëror i Muzeve drejtohet dhe thirret nga kryetari. Kryetari thërret mbledhjet e KSHM-së jo më pak se një herë në tre muaj.

2. Njoftimit për thirrjen e mbledhjes i bashkëlidhet rendi i ditës dhe materialet e çështjeve për të cilat do të diskutohet në mbledhje. Rendi i ditës miratohet nga kryetari, pas propozimit të sekretarisë teknike të KSHM-së apo të anëtarëve të Komisionit. Njoftimi për zhvillimin e mbledhjes përgatitet dhe njoftohet nga sekretaria teknike një javë përpara datës së mbledhjes. Në raste të veçanta, kur për një gjë të tillë bien dakord shumica e anëtarëve të KSHM-së, ai mbledhet dhe më parë se data e njoftimit.

3. Mbledhjet e KSHM-së zhvillohen gjithmonë në prani të kryetarit dhe janë të vlefshme kur në to marrin pjesë 50 + 1 për qind e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të të pranishmëve.

4. Në rast të mosarritjes së shumicës së kërkuar, sipas pikës 3, kryetari thërret mbledhjen pasardhëse jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga data e anulimit të mbledhjes.

5. Vendimet e KSHM-së merren me votim të hapur.

6. Anëtarët e KSHM-së, që janë të pranishëm në mbledhje, votojnë për vendimmarrjen e një çështjeje të caktuar, me përjashtim të rasteve kur kanë pengesë ligjore në kuptim të nenit 37 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”, konfliktit të interesit, diskriminimit ose rasteve të tjera të ndaluara me ligj. Në këto raste, anëtari i Komisionit njofton kryetarin për mospjesëmarrjen në vendimmarrjen e çështjes së caktuar që pritet të zhvillohet në mbledhjen e Komisionit.

7. Kryetari i Komisionit Shtetëror të Muzeve voton i fundit. Në rastet kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

8. Vendimet e KSHM-së nënshkruhen nga kryetari.

9. Sekretaria teknike e KSHM-së mban procesverbalin e mbledhjeve, i cili përfshin:

- a) orën, datën, vendin e mbledhjes;
- b) listëprezencën e pjesëmarrësve në mbledhje;
- c) çështjet e diskutuara nga anëtarët e Komisionit;
- ç) formën dhe rezultatin e votimeve.

10. Procesverbali u paraqitet për shqyrtim e miratim anëtarëve të Komisionit në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Në rastet kur çështjet e propozuara zgjasin më shumë se një mbledhje, procesverbali miratohet nga anëtarët e Komisionit në përfundim të mbledhjes përkatëse.

IV. PARAQITJA E PROPOZIMEVE

Të drejtën e paraqitjes së projekteve, teknike dhe të përmbajtjes, për shqyrtim e miratim pranë Komisionit Shtetëror të Muzeve, e kanë personat fizikë ose juridikë sipas kritereve të miratuara nga Komisioni Shtetëror i Muzeve, në përputhje me ligjin nr. 9386, datë 4.5.2005, “Për muzetë”.

V. TË TJERA

1. Vendimi nr. 775, datë 14.12.2005, i Këshillit të Ministrave, “Për kompetencat, përbërjen, funksionimin dhe mënyrën e mbledhjes e të shpërblimit të anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Muzeve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama